

**IT Panakeia shpk**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

---

## **PËRMBAJTJA:**

	<b>FAQE</b>
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 20

**“IT Panakeia” shpk**  
(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar  
më 31 dhjetor 2019**

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	3,964,513	5,695,267
Llogari te arketueshme tregetare	5	3,773,449	709,475
Llogari te arketueshme nga palet e lidhura	6	9,639,302	12,204,274
Te tjera llogari te arketueshme	7	4,661,336	4,063,034
Inventari	8	3,295,685	3,050,132
Shpenzime te shtyra	9	103,200	-
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>25,437,485</b>	<b>25,722,182</b>
<b>Aktivët afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	10	1,390,220	1,793,840
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>1,390,220</b>	<b>1,793,840</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>26,827,705</b>	<b>27,516,022</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari te pagueshme tregetare	11	935,483	1,322,769
Llogari te pagueshme ndaj paleve te lidhura	12	24,935,576	24,182,356
Detyrime tatimore	13	933,674	782,679
Te tjera detyrime	14	-	34,998
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>26,804,733</b>	<b>26,322,802</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		-	-
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>26,804,733</b>	<b>26,322,802</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali i nenshkruar	15	400,000	400,000
Rezerva ligjore		40,000	40,000
Rezerva te tjera		-	-
Fitimi i ushtrimit		(417,028)	753,220
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>22,972</b>	<b>1,193,220</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>26,827,705</b>	<b>27,516,022</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**"IT Panakeia" shpk***(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Performancës  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	16	19,401,344	21,550,265
Te ardhura te tjera te shfrytezimit	17	(24,274)	(32,120)
<b>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</b>		<b>(11,790,471)</b>	<b>(10,895,457)</b>
1) Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	18	(8,980,053)	(6,146,351)
2) Te tjera shpenzime	19	(2,810,418)	(4,749,106)
<b>Shpenzime të personelit</b>	20	<b>(7,570,225)</b>	<b>(9,130,988)</b>
1) Paga dhe shpërblime		(6,517,780)	(7,916,740)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(1,052,445)	(1,214,248)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(403,620)	(523,212)
Shpenzime të tjera të shfrytezimit	21	(129)	(86)
<b>Të ardhura të tjera</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Shpenzime financiare</b>		<b>290</b>	<b>-</b>
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur vecmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)		290	-
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>(387,085)</b>	<b>968,402</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	22	<b>(29,943)</b>	<b>(215,182)</b>
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(29,943)	(215,182)
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>(417,028)</b>	<b>753,220</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>(417,028)</b>	<b>753,220</b>


Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**“IT Panakeia” shpk***(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e ndryshimeve në Kapital  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**


	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017</b>	<b>400,000</b>	<b>40,000</b>	<b>19,083,728</b>	<b>117,185</b>	<b>19,640,913</b>
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2018</b>					
Fitimi / Humbja e vitit				753,220	753,220
Lëvizjet përmes kapitalit			117,185	(117,185)	-
Dividendë të paguar			(19,200,913)		(19,200,913)
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018</b>	<b>400,000</b>	<b>40,000</b>	<b>-</b>	<b>753,220</b>	<b>1,193,220</b>
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2019</b>					
Fitimi / Humbja e vitit				(417,028)	(417,028)
Lëvizjet përmes kapitalit			753,220	(753,220)	-
Dividendë të paguar			(753,220)		(753,220)
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019</b>	<b>400,000</b>	<b>40,000</b>	<b>-</b>	<b>(417,028)</b>	<b>22,972</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë aprovuar nga administratori IT Panakeia shpk më 23.03.2020 dhe janë firmosur si më poshtë:

  
 Jonida SAKA  
 Ekonomist



  
 Algert BREGU  
 Administrator

**"IT Panakeia" shpk***(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitim / Humbja e vitit	(417,028)	753,220
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	33,299	(16,068)
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	(29,943)	(215,182)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	403,620	523,212
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(1,170,561)	8,231,971
Rënie/(rritje) në inventarë	(245,553)	98,301
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	516,929	13,871,501
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(34,998)	(740,788)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>(944,235)</b>	<b>22,506,167</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	-	-
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		
Interes i paguar		
Dividendë të paguar	(753,220)	(19,200,913)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>	<b>(753,220)</b>	<b>(19,200,913)</b>
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(1,697,455)	3,305,254
Mjetet monetare në fillim të periudhës	5,695,267	2,373,945
<i>Efkti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(33,299)	16,068
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>4 3,964,513</b>	<b>5,695,267</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## **1. Informacion i përgjithshëm**

Shoqëria "IT Panakeia" Shpk është regjistruar si shoqëri me përgjegjesi të kufizuar pranë rregjistrave të Qendres Kombëtare të Regjistrimeve me datë 20/03/2007. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të ligjit Nr.7638 datë 19 Nentor 1992 "Per Shoqëritë Tregtare" dhe statuti i saj.

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 400,000 leke i zotëruar 100% nga ortakët i vetëm i shoqërisë Investment SHERKO - ikub GROUP shpk.

Administrator i shoqërisë është Z. Algert Bregu.

Selia e shoqërisë ndodhet në rrugën Abdyl Frasheri, EGT Tower, Pll. 11/1, Kati 4, Tirane. Ajo është e regjistruar në Degen e Tatimeve, Tirane me NIPT K71702025M.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është "Konceptimi, zhvillimi, implementimi, testimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Import-eksport të mallrave, materialeve, shërbimeve etj. Tregtim elektronik dhe fizik i mallrave, materialeve, shërbimeve, të çfaredolloj natyre ato qofshin, të lejuara nga ligji. Aktivitet tregtar, financiar, dhenie-marrje me qira etj".

Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria kishte 12 punonjës (2018: 15 punonjës).

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 datë 30 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

### **2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### **2.5. Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

### **2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

### **2.5.2. Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

## **2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël**

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

## **3. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### **3.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

<b>Kursi i këmbimit</b>	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Euro/LEK	121.77	123.42
USD/ LEK	108.64	107.82



### **3.2. Instrumentat financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

#### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

#### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

#### *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### **3.2. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

### **3.3. Aktive afatgjata materiale**

#### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivitetet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

#### *iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

<b>Kategoria e aktiveve</b>	<b>Metoda e Amortizimit</b>	<b>Norma e Amortizimit</b>
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %

*iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

### **3.4. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

### **3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

### **3.6. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

### **3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### **3.8. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

### **3.9. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

### **3.10. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

### **3.11. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar fluksin e pritshëm të ardhshëm të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

### **3.12. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

**“IT Panakeia” shpk**  
**Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**4. Mjete monetare**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mjete monetare në bankë	<b>3,557,939</b>	<b>5,312,817</b>
Llogari rrjedhëse	3,557,939	5,312,817
Mjete monetare në arkë	406,574	382,450
	<b>3,964,513</b>	<b>5,695,267</b>

**5. Llogari të arkëtueshme tregëtare**

Llogaritë e arkëtueshme tregëtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Klientë	3,773,449	709,475
	<b>3,773,449</b>	<b>709,475</b>

**6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura**

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
ikub.al	1,149,436	1,101,136
ikubINFO shpk	7,108,516	9,721,788
	<b>8,257,952</b>	<b>10,822,924</b>

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Investment Sherko	83,000	83,000
ikub.al	1,298,350	1,298,350
	<b>1,381,350</b>	<b>1,381,350</b>

**7. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Tatim fitimi	966,034	995,977
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	3,695,302	3,067,057
	<b>4,661,336</b>	<b>4,063,034</b>

**8. Inventari**

Gjendja e inventarit më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mallra	<u>3,295,685</u>	<u>3,050,132</u>
	<u><b>3,295,685</b></u>	<u><b>3,050,132</b></u>

**“IT Panakeia” shpk**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**9. Aktive Afatgjata Materiale**

	<b>Mobilje e pajisje zyre</b>	<b>Pajisje informatike</b>	<b>Te tjera</b>	<b>Totali</b>
<b>Kosto</b>				
Gjendja më 1 janar 2017	408,331	5,167,535	3,490,591	9,066,457
Shtesa	15,000	39,642	78,970	133,612
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>423,331</b>	<b>5,207,177</b>	<b>3,569,561</b>	<b>9,200,069</b>
Shtesa	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>423,331</b>	<b>5,207,177</b>	<b>3,569,561</b>	<b>9,200,069</b>
Shtesa	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>423,331</b>	<b>5,207,177</b>	<b>3,569,561</b>	<b>9,200,069</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>				
Gjendja më 1 janar 2017	(165,930)	(3,622,354)	(2,435,375)	(6,223,659)
Amortizimi i vitit	(47,622)	(388,793)	(222,943)	(659,358)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>(213,552)</b>	<b>(4,011,147)</b>	<b>(2,658,318)</b>	<b>(6,883,017)</b>
Amortizimi i vitit	(41,956)	(299,007)	(182,249)	(523,212)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>(255,508)</b>	<b>(4,310,154)</b>	<b>(2,840,567)</b>	<b>(7,406,229)</b>
Amortizimi i vitit	(33,565)	(224,256)	(145,799)	(403,620)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>(289,073)</b>	<b>(4,534,410)</b>	<b>(2,986,366)</b>	<b>(7,809,849)</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>				
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>209,779</b>	<b>1,196,030</b>	<b>911,243</b>	<b>2,317,052</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>167,823</b>	<b>897,023</b>	<b>728,994</b>	<b>1,793,840</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>134,258</b>	<b>672,767</b>	<b>583,195</b>	<b>1,390,220</b>

**“IT Panakeia” shpk**  
**Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**10. Shpenzime te periudhave te ardheshme**

Gjendjet e shpenzimeve te periudhave te ardheshme me 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 jane si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime të periudhave të ardhshme	103,200	-
	<u>103,200</u>	<u>-</u>

**11. Llogari të pagueshme tregëtare**

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve për faturat e pranuar dhe ato të pambërritura. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 dhjetor 2019 dhe 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Furnitorë	873,831	1,274,810
Furnitorë për fatura të pambërritura	61,652	47,959
	<u>935,483</u>	<u>1,322,769</u>

**12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura**

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
<b>Të pagueshme tregtare</b>		
ikub.al	1,981,443	1,981,443
<b>Dividendë të pagueshëm</b>		
Div.Investment SHERKO-ikub Group	22,954,133	22,200,913
	<u>24,935,576</u>	<u>24,182,356</u>



**“IT Panakeia” shpk**  
**Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**13. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	140,435	159,770
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	46,797	56,399
TVSH për t'u paguar	746,442	566,510
	<u><b>933,674</b></u>	<u><b>782,679</b></u>

**14. Të tjera detyrime**

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe detyrime të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime ndaj personelit	-	34,998
	<u>-</u>	<u><b>34,998</b></u>

**15. Kapitali aksionar**

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 400,000 leke i zotëruar 100% nga ortakët e vetëm të shoqërisë Investment SHERKO - ikub GROUP shpk.

**16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Sherbime programimi e zhvillimi	6,816,383	7,746,143
Te ardhura nga komisione ndërmjetësimi	715,287	902,208
Te ardhura GIS	-	5,044,131
Shitje mallra	11,329,674	7,857,783
Te ardhura nga sherbime të tjera	540,000	-
	<u><b>19,401,344</b></u>	<u><b>21,550,265</b></u>

### 17. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe të ardhura të tjera financiare, që detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Fitime nga këmbimet valutore	23,511	37,185
Humbje nga këmbimet valutore	(47,785)	(70,169)
Te ndryshme	-	864
	<u><b>(24,274)</b></u>	<u><b>(32,120)</b></u>

Rakordimi i të ardhurave të deklaruara në FDP e Tatim Fitimit me xhiron e deklaruar në FDP e TVSH është si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më Dhjetor 31, 2019</u>
<b>Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne</b>	
Shitje total te deklaruar ne FDP TVSH	19,401,344
<b>Shitje te deklaruar ne FDP qe jane te ardhuran ne PASH</b>	<u><b>19,401,344</b></u>
Shitje mallrash	11,329,674
Sherbime	8,071,670
<b>Te ardhura te deklaruar ne PASH te cilat jane deklaruar shitje ne FDP</b>	<u><b>19,401,344</b></u>
Te ardhurat nga interesat	290
Fitim nga kembimet valutore	23,511
<b>Total te ardhura te deklaruar FDP e Tatim Ftimit</b>	<u><u><b>19,425,145</b></u></u>

### 18. Lëndet e para dhe shërbimet

Shërbimet për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 dhe atë të mbyllur më 31 Dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Sherbime programimi	-	78,240
Sherbime zhvillimi	1,084,920	870,402
Kosto e mallrave te shitur	7,122,113	4,485,212
Sherbim reklamimi	773,020	712,497
	<u><b>8,980,053</b></u>	<u><b>6,146,351</b></u>

**“IT Panakeia” shpk**  
**Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**19. Të tjera shpenzime**

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>
Qira Zyra	-	1,095,053
Qira platforma ebuy.al	-	333,333
Sherbime konsulence	221,567	229,148
Shërbime telefonike+internet+postare	1,742,823	1,739,427
Komisione bankare	122,544	138,302
Taksa vendore	67,000	67,000
Blerje kancelari dhe te ngjashme	48,357	61,981
Konsum uje i pijshem	-	10,500
Shpenzime mirembajtje pajisje dhe zyre	5,667	190,349
Shpenzime karburanti	-	405,600
Shpenzime te ndryshme	602,460	478,413
	<b>2,810,418</b>	<b>4,749,106</b>

**20. Shpenzime të personelit**

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>
Shpenzime për paga	6,517,780	7,916,740
Shpenzime për sigurime shoq e shend	1,052,445	1,214,248
	<b>7,570,225</b>	<b>9,130,988</b>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2019 është 12 (2018:15).

**21. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit**

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>
Gjoba dhe penalitete	129	86
	<b>129</b>	<b>86</b>

**“IT Panakeia” shpk**  
**Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**22. Shpenzime financiare Neto**

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga interesat	290	-
	<u>290</u>	<u>-</u>

**23. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2018;15%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
	<u>Totali</u>	<u>Totali</u>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>(387,085)</b>	<b>968,402</b>
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	<b>586,702</b>	<b>466,143</b>
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	129	86
Shpenzime të tjera pa dokumenta	586,573	466,057
<b>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</b>	<b>199,617</b>	<b>1,434,545</b>
Humbje fiskale e mbartur		
<b>Fitimi i tatueshem</b>	<b>199,617</b>	<b>1,434,545</b>
<b>Shkalla tatimore e tatim fitimit</b>	<b>15%</b>	<b>15%</b>
<b>Tatim fitimi @15%</b>	<b>29,943</b>	<b>215,182</b>
<b>Fitimi/humbja e Vitit</b>	<b>(417,028)</b>	<b>753,220</b>

<i>Tatim mbi fitimin</i>	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Tatimi i derdhur paradhenie	995,977	1,211,159
Tatimi i vitit ushtrimor	29,943	215,182
Tatimi i derdhur teper/(per tu paguar)	966,034	995,977

**“IT Panakeia” shpk**  
**Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**24. Transaksionet me palët e lidhura**

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
<b>Të arketueshme nga palët e lidhura</b>		
<i>Të arketueshme tregtare</i>		
ikub.al	1,149,436	1,101,136
ikubINFO shpk	7,108,516	9,721,788
<b>Të arketueshme te tjera</b>		
Investment Sherko	83,000	83,000
ikub.al	1,298,350	1,298,350
	<u>9,639,302</u>	<u>12,204,274</u>
	<u>Për vitin e mbyllur</u>	<u>Për vitin e mbyllur</u>
	<u>më 31 dhjetor 2019</u>	<u>më 31 dhjetor 2018</u>
<b>Shitje ndaj palëve e lidhura</b>		
ikubINFO	4,470,863	12,835,679
ikub.al	40,250	40,238
	<u>4,511,113</u>	<u>12,875,916</u>
<b>Blerje nga palët e lidhura</b>		
ikub.al	-	479,834
	<u>-</u>	<u>479,834</u>

**25. Angazhime dhe pasiguri**

*Çeshtje gjyqesore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund të kerkoje rregullime të ketyre pasqyrave financiare.

*Detyrimet tatimore*

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

**26. Ngjarje pas bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.